



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

894/1  
Nr. prot.

Shkodër, më 01.01.2026



Lënda: Mbi Vendimin Nr. 84, datë 23.12.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21/2025 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 39/2025, "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 29, neni 54, shkronja "n", shqyrtoi *Vendimin Nr. 84, datë 23.12.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës "Për ngritjen e këshillit vendor të sigurisë publike për Bashkinë Vau Dejës"*

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKTI**

**Holta DUDA**





**BASHKIA VAU DEJES**  
**KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

**VENDIM**

Nr. 84, Datë 23/12/2025

**“PËR KRIJIMIN E KËSHILLIN VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË VAU DEJËS DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIN E TIJ”**

Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 100/3 të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”; neni 29 dhe neni 54 pika k të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligji nr. 69/2012 “Për Arsimin Parauniversitar”, i ndryshuar; Ligji nr.82/2024 “Për Policinë e Shtetit”; Ligji nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, i ndryshuar; Ligji nr.8756, datë 26.03.2001 “Për Emrigjencat Civile”, i ndryshuar; Ligjin nr.121/2016 “Për Sherbimet e kujdesit Shëndetësor” ; Ligji nr.22/2018 “Për Strehimin Social”; Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar; Ligji nr. 9863/ 2008, “Për Ushqimin”; Ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorit”; Ligji nr. 81/2017 “Për Zonat e mbrojtura” i ndryshuar; Ligj nr.9669/ 2006 “Për Masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”; i ndryshuar; Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” Ligji nr.9780/2007 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e Territorit nga Ndertimet e Kundëligjshme”; VKM-në nr.678, datë 30.10.2024 “Për përbërjen , rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendor të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet” pika 2; shkresën nr.6898 prot, datë 14.11.2024 “Prefekti i Qarkut Shkodër për Veprim ; Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026; Strategjise Kombetare për Luftën kundër Ekstremizmit të dhunshëm;- **Akteve Nderkombetare** si: Deklarata Universale e te drejtave dhe lirive të Njeriut; Konventa për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e Amenduar; Prakika të mira për ndërtimin e Partneritetit Polici-Publik botuar nga OSCE (2008); shkresën nr.6898 prot, datë 14.11.2024 “Prefekti i Qarkut Shkodër për Veprim si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Juridike, **Këshilli i Bashkisë Vau Dejës.**

**VENDOSI:**

1. Të miratoj ngritjen e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Vau Dejës, i cili do të



funksionoi si një organizatë koordinuese dhe identifikues për problematika që lidhen me çështjet e rendit dhe sigurisë në komunitet si rezultat.

2. Të miratoj rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Vendore të Sigurisë Publike, shkresa bashkëngjitur.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi administrata e Bashkisë Vau Dejës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"), ndryshuar.

**KRYETAR KËSHILLI**

Ervis Shimaj




**SEKRETAR KËSHILLI**

Ardian Çelepija



Miratur me 20 vota

Vota Pro 20

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 30.12 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA JURIDIKE, SEKTORI I PROKURIMEVE DHE ASETIVE**  
**SEKTORI LIGJORE , KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE**

Nr. 6721 Prot.

Vau Dejës, me 14.11.2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim dhe miratim Projekt-Vendimi

**Z. Ervis Shimaj**  
**Kryetar i Këshillit Bashkiak Vau Dejës**

I nderuar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim të hartuar projekt-vendimin "**Për Ngritjen e Këshillit Vendorë të Sigurisë Publike** ", si një strukturë bashkëpunimi ndërinstitucionale që synon forcimin e rendit dhe sigurisë në territorin e Bashkisë Vau Dejës.

*Duke ju uruar punë të mbarë !*

**KRYETARI**  
**Kristian Shkreli**

**ME VENDIM DELEGIM**  
**ZV/KRYETARI**  
**Aleksandra Gjoni**

Konceptoi: S. Ismjalaj  
Miratoi: M. Deda

Datë : \_\_\_\_\_  
Nr. i faqeve A4 të projekt vendimit: \_\_\_\_\_.  
Nr. I fletëve të relacionit shoqërues: \_\_\_\_\_.  
Nr. I fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt-vendimin: \_\_\_\_\_.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETJEVE**  
**SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE**

**PROJEKT VENDIM**  
**Nr. 66, Datë 14/11 /2025**

**“PËR KRIJIMIN E KËSHILLIN VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË VAU DEJËS DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIN E TIJ”**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_/\_\_\_\_/2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 100/3 të *”Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”*; neni 29 dhe neni 54 pika k të Ligjit nr.139/2015 *”Për Vetëqeverisjen Vendore”*; Ligji nr. 69/2012 *”Për Arsimin Parauniversitar”*, i ndryshuar; Ligji nr.82/2024 *”Për Policinë e Shtetit”*; Ligji nr.89/2022 *”Për Policinë Bashkiake”*, i ndryshuar; Ligji nr.8756, datë 26.03.2001 *”Për Emrigjencat Civile”*, i ndryshuar; Ligjin nr.121/2016 *”Për Sherbimet e kujdesit Shëndetësor”*; Ligji nr.22/2018 *”Për Strehimin Social”*; Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 *”Për Mbrojtjen e Mjedisit”*, i ndryshuar; Ligji nr. 9863/ 2008, *”Për Ushqimin”*; Ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 *”Për Mbrojtjen e Knumatorit”*; Ligji nr. 81/2017 *”Për Zonat e mbrojtura”* i ndryshuar; Ligj nr.9669/ 2006 *”Për Masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”*; i ndryshuar; Ligji nr. 18/2017 *”Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”* Ligji nr.9780/2007 *”Për Inspektimin dhe mbrojtjen e Territorit nga Ndertimet e Kundëligjshme”*; VKM-në nr.678, datë 30.10.2024 *”Për përbërjen , rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendor të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet”* pika 2; shkresën nr.6898 prot, datë 14.11.2024 *”Prefekti i Qarkut Shkodër për Veprim ; Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026; Strategjise Kombetare për Luftën kundër Ekstremizmit të dhunshëm;- Akteve Nderkombetare si: Deklarata Universale e te drejtave dhe lirive të Njeriut; Konventa për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e Amenduar; Prakika të mira për ndërtimin e Partneritetit Polici-Publik botuar nga OSCE (2008); shkresën nr.6898 prot, datë 14.11.2024” Prefekti i Qarkut Shkodër për Veprim si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Juridike,*

## VENDOSI:

1. Të miratoj ngritjen e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Vau Dejës, i cili do të funksionoi si një organizatë koordinuese dhe identifikues për problematika që lidhen me çështjet e rendit dhe sigurisë në komunitet si rezultat.
2. Të miratoj rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Vende të Sigurisë Publike, shkresa bashkëngjitur.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi administrata e Bashkisë Vau Dejës.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**ME VENDIM DELEGIMI**

**ZV/KRYETARI**

**Aleksandra Gjoni**



**KRYETARI**  
**Kristian Shkreli**

*Konceptoi: Silvana Ismajlaj*

*Miratoi: Marinela Deda*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE**  
**SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE**

Nr.     Prot.

Vau Dejës, me 14.11.2025

**RELACION**

**“PËR KRIJIMIN E KËSHILLIN VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË VAU DEJES DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIN E TIJ”**

*Të nderuar Këshilltarë,*

Këshillat vendor të sigurisë publike (në vijim KVSP) janë struktura konsultative mbi çështjet e sigurisë publike në nivel vendor që funksionon pranë Bashkive. Ato janë forume me përfaqësues të institucioneve publike, nga ku kërkohet përgjegjësi institucionale për adresimin e problematikave dhe zgjidhjen e tyre sipas tagrit që secili institucion ka sipas legjislacioneve në fuqi.

“Këshillin Vendor të Sigurisë Publike” i cili do të funksionoi si një organizatë koordinuese, identifikues për problematika që lidhen me çështjet e rendit dhe sigurisë në komunitet.


Duke pasur parasysh se zhvillimi ekonomik dhe social i vendit lidhet ngusht me forcimin e sigurisë publike, uljen e kriminalitetit, zbatimin e ligjit, eliminimin e dhunës dhe mbrojtjen e grupeve të cënueshme, luftën ndaj ekstremizmit të dhunshëm, luftën ndaj kultivimit dhe përdorimit të lëndëve narkotike apo përballjen me çdo fenomen tjetër krimi dhe paligjshmërie kërkojmë me anë të këtij projekt vendimi të realizojmë ngritjen e KVSP pranë Bashkisë Vau Dejës. Ngritja e Këshillave Vendor të Sigurisë Publike në nivel lokal krijon premisat për një qasje të re strategjike lokale ndaj fenomeneve të pasigurisë, ku sjell:

1. Përfitim të drejtpërdrejt për komunitetet.
2. Fuqizon bashkëpunimin midis komuniteteve dhe aktorëve qeverisës.
3. Nxit ndërveprim për të adresuar çështjet e sigurisë publike.

Kuadri ligjor në të cilin mbështet themelimi i KVSP janë:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
3. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
4. Praktika të Mira për Ndërtimin e Partneritetit Polici-Publik, botuar nga OSCE (2008)
5. Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar
6. Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar

Konceptoi: S. Ismajlaj  
Miratoi: M. Deda

  
 2 ✓



**RREGULLORE**  
**“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT VENDOR**  
**PËR SIGURINË PUBLIKE”**

## **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

1. Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave dhe procedurave që zbatohen për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Vendor për Siguri Publike(KVSP) ngritur pranë Bashkisë Vau Dejës.
2. KVSP funksionin si një mekanizëm koordinues , identifikues, dhe menaxhues pranë Bashkisë mbi problematikat që lidhen me çështje të sigurisë në komunitet çështje të rendit dhe sigurisë publike dhe ushtron veprimtarine në përputhje me ligjin 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”.
3. Veprimtaria e KVSP mbështetet para së gjithash në partneritetin dhe në bashkëpunim mes Bashkisë Vau Dejës, Policisë, Prokurorisë dhe ndërveprimet të tyre me aktorët e tjerë publike dhe jopublike në të mirë të Bashkisë Vau Dejës.

### **Neni 2**

#### **Objekti**

1. Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i përbërjes, detyrave, përgjegjësisë, mënyrën e funksionimit të Këshillit Vendor për Siguri ngritur pranë Bashkisë Vau Dejës.
2. Ky është një organ konsultues për çështje të sigurisë, që në bashkëpunim me policinë dhe institucione të tjera sigurie shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë, në të mirë të Bashkisë Vau Dejës

### **Neni 3**

#### **Baza Ligjore**

1. Aktet kombëtare janë:
  - Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
  - Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 29/1;
  - Ligji nr. 82/2024” Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.
  - VKM 678, datë 30.10.2024” Për përbërjen , rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendor të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet” .
  - Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026.
  - Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm;
  - Strategjia Afatmesme e Prokurorisë së Përgjithshme 2018-2020;
2. Aktet ndërkombëtare janë:

Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut;

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e amenduar;

Praktika të Mira për Ndërtimin e Partneritetit Polici-Publik, botuar nga OSCE (2008);



## **KREU II**

### **Funksionimi i Këshilli Vendor për Siguri Publike**

#### **Neni 4**

##### **Përberja e KVSP**

1. Këshilli Vendor për Siguri Publike përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

- Kryetari i Bashkisë Vau Dejës
- Sekretar Teknik
- Shefi i Komisarariatit të Policisë Vau Dejës
- Drejtuesi i Policisë Bashkiake
- Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
- Drejtues i Emirgjencave Civile në Bashkia
- Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Sherbimit Social Shtetëror
- Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
- Përfaqësues i Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor
- Përfaqësues i Agjencisë Rajonale të Mjedisit(Shkodër-Lezhë)
- Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit
- Përfaqësues i Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura
- Kordinator Vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të Dhunës në marrdhenjet Familjare dhe i Njësisë Për mbrojtjen e fëmijeve
- Kryeinspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit
- Përfaqësues i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit

2. Në mbledhjen Këshilli Vendor për Siguri Publike Vau Dejës mund të ftohen pesë ditë përpara të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve publike të ndryshme në nivel vendor apo të grupeve të interesit, në varësi të tematikës së mbledhjes si:

- a) Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm
- b) Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm;
- c) komunitetet fetare;
- d) organizatat e shoqërisë civile (organizatat rinore, të grave, të bizneseve të pakicave kombëtare, të universiteteve, të mediave lokale), komunitetit, sipas rastit;
- e) Këshilli Vendor i Rinisë;
- f) Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit;
- g) shoqatat e njësisë të vetëqeverisjes vendore;
- h) Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;
- i) shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve

3. Anëtarët e ftuar në mbledhjet e KVSP angazhohen në format këshillues për shkëmbim informacioni ndërinstitutional.

## **Neni 5**

### **Kryetari i KVSP**

1. Kryetari Bashkisë është kryetari i KVSP.
2. Kryetari ushtron përgjegjësitë si më poshtë:
  - a) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të KSVP;
  - b) koordinon dhe mbikëqyr administrimin e të gjitha aktiviteteve të KVSP;
  - c) përfaqëson KVSP në marrëdhëniet me të tretët, duke përfshirë dhe bashkëpunimet me organizmat ndërkombëtare;
  - d) informon Këshillin Bashkiak për veprimtarinë e KVSP së paku një herë në vit.

## **Neni 6**

### **Përgjegjësitë e KVSP**

1. Mbështet dhe inkurajon një partneritet të qëndrueshëm me të gjitha institucionet e përfshira në KVSP me qëllim identifikimin dhe parandalimin e problematikave në kuadër të sigurisë publike.
2. Koordinon, identifikon dhe menaxhon në nivel vendor problematikat që lidhen me sigurinë e komunitetit duke garantuar:
  - a) Mbrojtjen civile, në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse;
  - b) Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse;
  - c) Garantimin e mbarëvajtjes së mardhënieve në komunitet, prandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në territorin e saj.
- c) Parandalimin e kundravajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve dhe akteve të NJ.Q.V brenda juridiksionit të tyre dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.
1. Sipas rastit, KVSP komunikon me institucionet e qeverisjes qendrore për zbatimin e masave për parandalimin e krimit.
2. Mbështet dhe koordinon me organizata të shoqërisë civile, komunitetet fetare, komunitetin e biznesit angazhime konkrete në përballjen me sfidat e sigurisë në komunitet me qëllim parandalimin e konflikteve, sjelljeve antishoqërore, si dhe veprimeve të tjera të dhunshme.
3. Realizon dhe vlerëson takimet konsultuese publike me përfaqësues të komuniteteve vendore për të ndërtuar axhendën vendore të sigurisë dhe përditësimin e saj në vazhdimësi.
4. KVSP miraton, zbaton, dhe rishikon planin shumë-aktorial vendor.
5. Plani shumë aktorial vendor për parandalimin dhe luftën ndaj krimit në nivel vendor është një dokument i cili përfshin tërësinë e risqeve të vlerësuara, intensitetin e tyre, si dhe masat përkatëse, institucionet përgjegjëse dhe afatet kohore për realizimin e tyre. Afati i zbatimit të Planit është vjetor dhe përditësohet në vazhdimësi.
6. Institucionet përgjegjëse të përfaqësuara me anëtarë në KVSP do të shkëmbejnë informacione në përputhje me legjislationin në fuqi dhe KVSP do të përdorë informacion për të lehtësuar marrjen e vendimeve lokale dhe zgjidhjet e problemeve në partneritet.



## **Neni 7**

### **Mbledhjet e KVSP**

1. Mbledhja e KVSP ushtron, kompetencat e mëposhtme:
  - a) Miraton, vlerëson zbatimin dhe rishikon planin vendor;
  - b) Përcakton drejtimet kryesore të axhendës së sigurisë publike në nivel vendor;
2. Mbledhjet e KVSP mbahen së paku 2 herë në vit. Ato zhvillohen në ambientet e Bashkisë Vau Dejës, me përjashtim të rastit kur Kryetari vendos ndryshe.
3. Në rastet e ngjarjeve të ndryshme të papritura apo me një ndjeshmëri të veçantë, Kryetari mund të realizojë mbledhje me anëtarësi më të vogël pjesëmarrësish që lidhen drejtpërdrejtë me problematikën.
4. Kryetari i KVSP i thërret dhe i kryeson mbledhjet e KVSP. Ftesa me rendin e ditës dhe materialet për shqyrtim u dërgohen anëtarëve të KVSP së paku 5 ditë punë para mbledhjes së radhës.
5. KVSP zhvillon punën në bazë të rendit të ditës të miratuar nga kryetari i KVSP.
6. Kryetari i KVSP jep fjalën, drejton debatin, dhe përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës.
7. Pas mbylljes së diskutimeve mes tyre, anëtarët e KVSP dakordësojnë vendime/akte me konsensus të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
8. Vendimet/aktet e miratuara në mbledhje nënshkruhen nga kryetari i KVSP. Sekretariati teknik merr mara për t'i shpërndarë një kopje të tij çdo anëtar.

## **Neni 8**

### **Metodologjia e hartimit dhe monitorimit të zbatimit të planit vendor**

1. Plani vendor buron nga komunikimi i hapur publik i drejtuesve të Bashkisë Sarandë, dhe anëtarëve KVSP-së me grupe interesi dhe qytetarë (të tillë si drejtuesit e shkollave të ndryshme, prindër, qeveritë e nxënësve, Kryetarët e fshatrave apo ndërlihdësit komunitarë, përfaqësues të bizneseve vendore, shoqërisë civile dhe medias).
2. Sekretariati Koordinues (neni 9) duke vlerësuar rreziqet, orienton edhe llojin e aktivitetit dhe institucionet përgjegjëse.
3. Plani i veprimit përmban një kalendar aktivitetesh dhe afatesh për organizimin e tyre të cilat synojnë adresimin e risqeve.
4. Plani shumëaktorial vendor diskutohet dhe miratohet në mbledhjen e radhës të KVSP.
5. Monitorimi i planit vendor realizohet nga drejtues të Bashkisë, Policisë dhe Prokurorisë, përmes takimeve konsultuese të hapura me komunitetin një herë në 6 muaj. Në këto takime publike konsultuese analizohet ecuria e zbatimit të planit shumëaktorial vendor dhe identifikohen nevojat për përditësimin e tij.
6. Rishikimi i planit vendor me objektiva apo masa të reja mbështetur në nevojat e identifikuar miratohet nga mbledhja e KVSP.
7. Një format tip i raportit të monitorimit të zbatimit të planit shumë-aktorial vendor hartohet nga Sekretariati Teknik dhe ai koordinues dhe miratohet nga kryetari i KVSP.



**Neni 9**  
**Sekretari teknik i KVSP**

1. KVSP cakton ne mbledhjen e tij të parë sekretarin teknik të KVSP i cili është një punonjës i Bashkisë.
2. Sekretari teknik, në bashkërendim të ngushtë me kryetarin e KVSP, kryen detyrat si më poshtë:
  - a) harton procesverbalet e mbledhjes, shkresat apo aktet e ndryshme të KVSP, mbajtjen e arkivës dhe protokollit të KVSP;
  - b) protokollon procesverbalet e mbledhjes;
  - c) koordinon me drejtorinë IT-së në bashki për arshivimin e rregjistrimit zanor të takimeve të mbajtura;
  - d) dërgon dhe ndjek njoftimet dhe veprime të tjera të sekretarisë;
  - e) përgatit materialin, rekomandimet apo vendimet e marra pas çdo takimi të KVSP;
  - f) mban listëprezencën e anëtarëve të pranishëm të KVSP dhe personave të tjerë të pranishëm në mbledhje;
  - g) koordinon me sektorin e mediave për përgatitjen e njoftimeve për publikim;
  - h) koordinon me sektorin e IT-së për publikimin e njoftimeve apo materialeve që do të publikohen;
  - i) kryen veprimet për publikimin e njoftimeve dhe akteve në faqen zyrtare të bashkisë apo në media duke koordinuar punën me koordinatorin për informim dhe njoftimet publike.
  - j) krijon kushtet e përshtatshme për zhvillimin e mbledhjeve dhe veprimtarive të KVSP.
3. Sekretari teknik merr pjesë në mbledhjet e KVSP.
4. Merr pjesë ne takimet e sekretariatit koordinues.

**Kreu III**  
**Transparenca dhe komunikimi me publikun**

**Neni 10**  
**Komunikimi me publikun**

1. KVSP komunikon me publikun pas çdo mbledhjeje përmes një komunikate për mediat, e cila, sipas natyrës së çështjeve të trajtuara, informon së paku për: a) kohën e mbledhjes; b) pjesëmarrjen; c) çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës; ç) thelbin e diskutimeve të KVSP.
2. Njoftimi për publikun përgatitet nga sekretari teknik në bashkëpunim me sekretariatin koordinues të KVSP.
3. Kryetari i KVSP urdhëron publikimin e njoftimit brenda 3 ditë/pune nga zhvillimi i mbledhjes.

**KREU IV**  
**DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**


**Neni 12**  
**Dispozitë kalimtare**

Ndryshimet dhe shtesat në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së nxjerrjes së saj.

**Neni 13**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi me miratimin nga mbledhja e Këshillit Bashkiak dhe publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Vau Dejës.

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/KRYETARI**  
**Aleksandra Gjoni**



**KRYETARI**  
**Kristian Shkreli**

Konceptoi: Silvana Ismajla  
Miratoi: Marinela Deda